




Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivety	25.05.2021	viti god Year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix
SIKMSHCK	2613/2021	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVES
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.332/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.2731/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.555/2019 të datës 19.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "Gjergj Fishta" Nr.11; në Komunën e Fushë Kosovës, kundër Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 25.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.555/2019 e datës 19.09.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, ka aplikuar në pozitën "Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme" në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit të shpallur në konkursin e datës 09.10.2018 në të cilin ishte zgjedhur si kandidati i suksesshëm. Këtë procedurë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e kishte vëzhguar pasi që pozita për të cilën ishin duke u zhvilluar procedurat e rekrutimit ishte e nivelit drejtues dhe në bazë të vendimit nr.368/2018 të datës 05.12.2018 procedurën e zhvilluar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për pozitën "Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme" kishte aprovuar si të rregullt, ku si kandidat i suksesshëm ishte për zgjedhur ankuesi

Ankuesi me datë 19.09.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me kërkesën për anulimin e konkursit të datës 14.09.2019 për pozitën "Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme" me pretendimin se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit nuk e kishte zbatuar vendimin e Këshillit të datës 05.12.2018 me numër nr.368/2018 me të cilin ishte konstatuar se procedura e zhvilluar për rekrutimin e së njëjtës pozitë "Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme" e shpallur në konkursin e datës 09.10.2018 ku kandidatë i suksesshëm ishte përzgjedhur ankuesi e që ishte në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për Shërbimin Civil, dhe se kjo pozitë është e mbuluar dhe nuk ka nevojë për konkurs të ri.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministrisë e Infrastrukturës. Ministria e Infrastrukturës më datë 02.10.2019 me numër protokolli:4618/2019, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës,13 faqe.

Më datë 01.11.2019 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020,ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit me ç' rast më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale nga ana e këshillit dhe nga kjo kohë është funksionalizuar këshilli me të gjitha përgjegjësit për vendosje në lidhje me ankesat e palëve.

Ankuesi , i pakënaqur me njoftimin e datës 01.11.2019 , të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18/11/2019 ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 15.04.2021, me numër A.nr.2731/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 01.11.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar këshillin që të vendos lidhur me ankesën e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllimin për të vendosë në mënyrë meritore në lidhje me këtë lëndë ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 19.09.2019 me numër protokolli 4401/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shpalljen për avancim të datës 14.09.2019; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës të datës 05.12.2018 me numër 368/2018; Përgjigjen në ankesë e datës 02.10.2019 me numër protokolli 4618/2019; Shkresën e Agjencisë Kundër Korrupsionit e datës 12.09.2019 me numër protokolli: 06-01/2159/19;

Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP i datës 08.10.2018; Shpalljen e rekrutimit të datës 09.10.2018; Autorizimin DASHC/MAP i datës 10.09.2018, Aktgjykimin A.nr.2731/2021 të Gjykatës Themelorë në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 15.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që duhet të bëhet anulimi i konkursit të datës 14.09.2019 me numër Reference RN00005864 për pozitën "Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme" me pretendimin se Ministria e Infrastrukturës i ka shkelur dispozitat ligjore që rregullojnë Shërbimin Civil pas që nuk e kishte zbatuar vendimin e Këshillit të datës 05.12.2018 me numër nr.368/2018 me të cilin ishte konstatuar se procedura e zhvilluar për rekrutimin e pozitës së njëjtë "Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme" e shpallur me konkursin e datës 09.10.2018 ku kandidatë i suksesshëm ishte përzgjedhur ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës me datë 05.12.2018 ka nxjerrë vendimin me numër Nr.368/2019 me të cilin e ka aprovuar si të rregullt procedurën e rekrutimit për pozitën "Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme" të shpallur në konkursin e datës 09.10.2018 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ku si kandidat i suksesshëm ishte përzgjedhur ankuesi z.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit në përgjigjen e dhënë për Këshillin me datë 02.10.2019 dhe numër protokolli 4618/2019 ka bërë të qartë se ankuesi në kohën kur është përzgjedhur në pozitën e shpallur sipas konkursit të datës 09.10.2018 ka qenë i emëruar si Këshilltar Politik i Ministrisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit si dhe ka bashkangjitur edhe shkresën e pranuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit të datës 12.09.2019 me numër Prot: 06-01/2159/2019 sipas së cilës bëhet e qartë se, citoj: " Mbi bazën e dispozitave të sipërcituara, Agjencia Kundër Korrupsionit konstaton se përzgjedhja e zyrtarit të lartë publik z. në pozitën drejtuese Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit bie ndesh me dispozitat nga Neni 18 të Ligjit Nr.06/L-11 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik", ndërsa Neni 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-11 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik përcakton se: "Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë: 1.1. të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose Menaxhues, apo të përfshihet në kontrollin ose Auditimit e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të

lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre”, andaj në këtë kuptim Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit me rastin e mos zbatimit të Vendimit të Këshillit të datës 05.12.2019 me nr.368/2018 nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit si dhe mos nxjerrja e akt emërimit për ankuesin i cili ishte përzgjedhur për pozitën drejtuese “Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme” të shpallur në konkursin e datës 09.10.2018, është veprim i bazuar pasi që me shkresën e Agjencisë Kundër Korrupsionit të datës 12.09.2019 me numër protokolli Nr.06-01/2159/19 është bërë e qartë se në rastin konkret kemi të bëjmë me konflikt interesi pasi që kandidati i përzgjedhur është Këshilltar Politik i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transporteve i cili është përzgjedhur në pozitën përkatëse si dhe përzgjedhja e tij në pozitën e lartcekur bie ndesh me parimet themelore të shërbimit civil të përcaktuara në dispozitat e Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil ne Republikën e Kosovës, neni 5 paragrafi 1, nën paragrafi 1.8 i cili përcakton se: “Nëpunësit civilë ushtrojnë detyrën në bazë të parimeve në vijim- Shmangia e konfliktit të interesit - Nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit”, andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar dhe ankesa si e tillë është refuzuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar, se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit pas marrjes së autorizimit nga DASHC/MAP të datës 10.09.2019 e ka shpallur konkursin e brendshëm për rekrutim me datë 14.09.2019 për pozitën “Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme”, rrjedhimisht fillimi i zhvillimi i procedurës së rekrutimit për pozitën në fjalë është hapur siç e përcaktojnë dispozita e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 4 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Njësia e Personelit në Institucion përkatës, e cila merr nëpunës civilë, pas autorizimit të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike, zhvillon procedurat konkurruese me qëllim të rekrutimi të nëpunësve civil ...” që derivojnë nga dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil ne Republikën e Kosovës, neni 11 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”, andaj me këtë rast Kolegji vlerëson se pretendimi i ankuesit se duhet anuluar konkursi i datës 14.09.2021 është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.
Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.332/2021, datë 25/05/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

